

IAP 10

12.2.2025



**INSTITUTI
ALBANOLOGJIK
PRISHTINË**

REPublika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA
INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA

Nr / Br. 26 Nr. faq / Br. str. 03
Data / Datum. 12.02.2025
PRISHTINE / PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS—REPUBLIC OF KOSOVA—REPUBLIKA KOSOVA
INSTITUTI I HISTORISË—INSTITUTE OF HISTORY—INSTITUT ZA ISTORIJU

Njësia Org. 1.H Nr. l. prot. 01/43/25
Org. Unit. 1.H Prot.N. 01/43/25
Org. Jed. 1.H Br. Prot. 01/43/25

Nr. i Faqeve 3 Data: 12.02.25
No. Pages 3 Date: 12.02.25
Br. Stranica 3 Datum: 12.02.25

PRISHTINE - A

**INSTITUTI I
HISTORISË “ALI
HADRI” PRISHTINË**

**INSTITUTI
PEDAGOGJIK I
KOSOVËS**

Prishtinë, më 12.02 2025

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI LIDHUR NDËRMJET
PALËVE:**

INSTITUTI ALBANOLOGJIK – PRISHTINË

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”

dhe

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Neni 1

Palët

1. Palët në këtë Marrëveshje janë: Instituti Albanologjik – Prishtinë, përfaqësuar nga u.d. i drejtorit z. Naim Berisha, Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, përfaqësuar nga drejtoresha znj. Teuta Shala dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës, përfaqësuar nga drejtori z. Osman Buleshkaj.

Neni 2

Objekti dhe Qëllimi

1. Objekti i kësaj marrëveshje mes palëve nënshkruese është vendosja e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën kërkimore-shkencore dhe akademike, duke përcaktuar fushëveprimin dhe objektivat e bashkëpunimit.
2. Palët bien dakord që të bashkëpunojnë me qëllim për realizimin e interesave të përbashkëta në fushën kërkimore – shkencore dhe akademike.
3. Nga kjo marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit do të përfitojnë studiuesit e palëve nënshkruese.

Neni 3

Veprimtaria e përbashkët e palëve

1. Palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të përcaktuar në **Nenin 1** të kësaj marrëveshjeje marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:
 - 1.1. Që të hartojnë një kalendar të aktiviteteve të përbashkëta shkencore për çdo vit respektiv.
 - 1.2. Që të bashkëpunojnë për organizimin dhe jetësimin e aktiviteteve shkencore dhe akademike: Konferencave, Simpoziumeve, Tryezave shkencore, ligjëratave, hulumtimeve dhe projekteve shkencore që organizohen nga këto institucione.
 - 1.3. Që të botojnë studime monografike dhe vëllime dokumentare nga fushat e përbashkëta të studimit dhe të angazhohen në promovimin e tyre.
 - 1.4. Përfshirja në projekte të punonjësve shkencorë nga radhët e institucioneve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, në vartësi të nevojave institucionale për zbatimin e projekteve gjegjëse.
 - 1.5. Që të organizojnë debate lidhur me aspekte të ndryshme nga fushat studimore që mbulojnë.
 - 1.6. Palët bien dakord për shkëmbimin e botimeve të tyre shkencore dhe akademike, me qëllim pasurimin e koleksioneve bibliotekare dhe mbështetjen e kërkimeve të stafit të tyre. Secila palë do të sigurojë nga një kopje të këtyre botimeve për bibliotekat përkatëse dhe, sipas kërkesës, nga një kopje për punonjësit e fushave të njëjta studimore.
 - 1.7. Palët pajtohen që të mbështesin administrativisht kërkuesit shkencorë për lehtësimin e procedurave për shfrytëzimin e literaturës në bibliotekat përkatëse të tyre.
 - 1.8. Përfshirja e stafit të institucioneve si anëtarë komisioni, në cilësinë e recensentit në botime të ndërsjella në varësi të fushave specifike.
 - 1.9. Për punën recensuese dhe punën tjetër të krijimtarisë shkencore dhe profesionale punonjësit shkencorë të angazhuar do të kompensohen bazuar në legjislacionin në fuqi.
 - 1.10. Angazhimi i stafit si anëtarë të komisioneve për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancime të stafit shkencor.
 - 1.11. Në bazë të nevojave të tyre, në raste të caktuara, krijojnë komisione profesionale dhe grupe pune të përbashkëta për zhvillimin e projekteve, strategjive dhe hulumtimeve.
 - 1.12. Palët pajtohen që të bashkëpunojnë edhe në çështje të tjera të cilat ndërlidhen me punët kërkimore-shkencore dhe akademike, duke përfshirë hartimin e rregulloreve dhe akteve tjera që ndërlidhen me punën e njëjtë të institucioneve lidhur me kërkimet shkencore dhe botuese.

Neni 4

Personat e kontaktit

1. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje personat e kontaktit janë drejtorët e institucioneve sipas Nenit 1 të kësaj marrëveshjeje, të cilët do të jenë përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve kërkimore- shkencore dhe akademike dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 5
Mosmarrëveshjet

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lind mes palëve në lidhje me këtë Marrëveshje zgjidhet me frymën e mirëkuptimit dhe përmes negociatave ndërmjet palëve nënshkruese.

Neni 6
Kohëzgjatja dhe anulimi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje është 4 (katër) vjet.
3. Me vullnetin e palëve Marrëveshja mund të ripërtërihet.
4. Kjo Marrëveshje mund të anulohet me vullnetin e palëve.
5. Pala që dëshiron anulimin është e obliguar që ta njoftojë palën tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.

Neni 7
Dispozita të përgjithshme


1. Palët obligohen që ta respektojnë këtë marrëveshje për gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në nenin 6 të saj.
2. Palët do të përmbushin detyrimet e parapara në këtë marrëveshje pa pretendime financiare ndaj palës tjetër.
3. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e hartuar në 6 (gjashtë) kopje, nga 2 (dy) për secilën palë nënshkruese.

Për

Instituti Albanologjik – Prishtinë

a.d. i drejtorit

Prof. asoc. dr. Naim Berisha



Për

Instituti i Historisë "Ali Hadri"

drejtoresha

Prof. dr. Teuta Shala Peli



Për

Instituti Pedagogjik të Kosovës

drejtori

Prof. asst. dr. Osman Buleshkaj

